

Titulli i lëndës: Letërsi e Evropësi e Evropës Juglindore

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë
Titulli i lëndës:	Letërsi e Evropës Juglindore
Niveli:	MA
Statusi i lëndës:	Me zgjedhje
Viti i studimeve:	Viti i pestë   Semestri i dhjetë
Numri i orëve në javë:	2+1
Kreditë ECTS:	6 ECTS
Koha / Vendi:	Klasa 74
Mësimdhënësi:	Prof. dr. Osman Gashi
Të dhënat kontaktuese:	+383 44 174 174 // <a href="mailto:osman.gashi@uni-pr.edu">osman.gashi@uni-pr.edu</a>
Përshkrimi i lëndës:	<p><i>Moduli i Letërsisë së Evropës Juglindore është paraparë që t'i përgatisë studentët e Departamentit të Letërsisë Shqipe që kanë kryer studimet e shkallës Bachelor, për punë hulumtuese – shkencore në një fushë specifike të studimeve letrare. Do të shpjegojë konceptet dhe zhvillimet teorike e historike – letrare të një hapësire të veçantë që shpesh quhet Letërsi ballkanike e herë herë edhe Letërsi e Evropës Juglindore.</i></p> <p><i>Puna me studentët (ligjërata, ushtrime e punë individuale) do të synojë që trajtojë një korpus letërsish të veçanta dhe shkrimtarët e dukuritë më reprezentative nga to në një kontekst diakronik e sinkronik, duke parë afritë e ndryshimet në kohë dhe hapësirë. Letërsisë e këtij krahu qëndrojnë në truallin e trashëgimisë së lashtë greke e romake si dhe kanë qenë edhe udhëkryq i shumë kulturave e religjioneve, si atyre evropiano – perëndimore e atyre të Lindjes – orientale.</i></p>
Qëllimet e lëndës:	<p><i>Qëllimi themelor i lëndës është që të njohë studentët me konceptet dhe postulatet themelore të Historisë së letërsisë – në veçanti me zhvillimet në Letërsinë e Evropës Juglindore. Gjithashtu do të bëhet përpjekje që studentët individualisht apo në grupe të hulumtojnë vetë dukuri, vepra e autorë të këtyre letërsive në kontekstin krahasimtar.</i></p>
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<p><i>Gjatë zhvillimit të ligjëratarave, ushtrimeve e konsultimeve si dhe në përfundim të kursit studentët do të kenë mundësinë:</i></p>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të fitojnë informacione dhe të demonstrojnë njohuri për letërsinë e shkruar në vende të ndryshme e në periudha të ndryshme historiko – letrare;</li> <li>• Të tregojnë aftësi për lexime kritike si dhe për shkrime kritike – analitike e krahasimtare;</li> <li>• Të përdorin me saktësi literaturën shkencore teoriko – letrare e historiko – letrare</li> </ul>
Metodat e mësimdhënies:	<i>Ligjërata, ushtrime kollokuime, teste, punë në grupe, shkrime esesh</i>
Metodat e vlerësimit:	Kufiri i kalueshmërisë së lëndës është 50 %. Vijueshmëria e studentit 10 %; Detyrat individuale të kryera në klasë 10 %; Detyrat individuale të kryera në shtëpi 10 %; Vlerësimi nga testet 20 %; Provimi final 50 %.
Literatura primare:	<i>Nikos Kazanxakis, Janis Ricos, Kostas Valetas, Jashar Qemal, Aziz Nesin, Orhan Pamuk, Nikita Stanesku, Mihal Sadoveanu, Ivo Andriq, Mesha Selimoviq, Danillo Kish, etj. (zgjedhje e veprave reprezentative sipas interesimeve të studentëve)</i>
Literatura shtesë:	<i>Yves Chevrel: Letërsi e krahasuar, Tiranë 2002; Rene Velek e Ostin Uoren: Teoria e letërsisë; Osman Gashi: Letërsia dhe miti, Prishtinë, 2014; Nathalie Piegay – Gros: “Introduction a l’intertextualite”, Paris, 1996</i>

Hartimi i planit mësimor	
Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	<i>Letërsia e Evropës Juglindore – nocione të përgjithshme</i>
Java 2:	<i>Evropa, Evropa Juglindore dhe Ballkani – midis kulturës së Perëndimit dhe të Lindjes</i>
Java 3:	<i>Zhvillimet historiko – letrare I</i>
Java 4:	<i>Zhvillimet historiko – letrare II</i>
Java 5:	<i>Konteksti evropian i letërsisë ballkanike</i>
Java 6:	<i>Mitologjia, Folklori, Religjioni</i>
Java 7:	<i>Kollokuium</i>
Java 8:	<i>Trashëgimia antike greke e romake I</i>
Java 9:	<i>Trashëgimia antike greke e romake II</i>
Java 10:	<i>Drejtimit dominante letrare në letërsinë e Evropës Juglindore (Klasicizmi e Romantizmi)</i>

Java 11:	<i>Drejtimit dominante letrare në letërsinë e Evropës Juglindore (Realizmi)</i>
Java 12:	<i>Letërsia moderne në vendet e Evropës Juglindore I</i>
Java 13:	<i>Zhanret e llojet e letërsisë bashkëkohore (Lirika, Romani, drama)</i>
Java 14:	<i>Konteksti ballkanik e evropian i letërsisë shqipe (I)</i>
Java 15:	<i>Konteksti ballkanik e evropian i letërsisë shqipe (II)</i>

### **Politikat akademike dhe kodi i sjelljes**

Mjetet që përdorën gjatë orëve të mësimit duhet të pastrohen dhe të ruhen në fund të orës mësimore. Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet e tjera elektronike (p.sh. iPod-ët) duhet të fikën (apo të kurdisen në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimit.

Laptopët dhe kompjuterët tabletë lejohen të përdorën vetëm në heshtje; aktivitetet e tjera, siç janë kontrollimi i e-mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet, janë të ndaluara.